



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VI  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 24/18  
Prishtinë, më 08.05.2018, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Jelena Bontiq, Mërgim Lushtaku dhe Fikrim Damka.

Munguan: Enver Hoti, Dardan Molliqaj dhe Blerim Kuçi.

Pjesëmarrës të ftuar: Fatmir Gashi-Zëvendës-ministër i Financave, Fehmi Mehmeti-Guvernator i Bankës Qëndrore (tutje:Guvernatori), Fitore Neziri nga BQK, Arben Mustafa – Këshilltarë nga BQK, Lulzim Rafuna nga MF, Ekrem Hysenaj-Drejtor i Departamentit nga Administrata Tatimore e Kosovës (tutje: ATK),Nahit Sharku –Zëvendës-Drejtor nga ATK, Sakip Imeri – Drejtor i përgjithshëm i ATK-së, Bahri Berisha – Drejtor i Doganës së Kosovës dhe Bajram Rexha nga DK.

Pjesëmarrës tjerë: Hykmete Bajrami – Deputete dhe anëtare e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Arbër Krasniqi – Monitorues nga KDI, Violeta Sfarça –Zyrtare për politika në ekonomi nga Ambasada Britanike, Dren Ajeti –Zyrtar ligjor nga Klubi i Prodhuesve, Ismail Shabani – Gazetar nga Kosova Press dhe Albulena Mavraj – Gazetare nga Epoka e Re.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

**R e n d i i d i t ë s :**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit ,dt.11 dhe 24 prill 2018;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-072 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare;**
- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale ;**
- 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave ;**

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar ;
7. Tatimi me Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit për realizimin e planit të të hyrave, për tremujorin e parë të vitit 2018;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik , Infrastrukturë, Tregti,Industri dhe Zhvillim Rajonal;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion ,Mandate ,Imunitete,Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
- 10.Të ndryshme.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetari** – konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht pa ndryshime.

### 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt.11 dhe 24 prill 2018

**Kryetari** - konstatoi se procesverbalet e datave 11 dhe 24 prill 2018, miratohen unanimisht pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-072 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare

**Kryetari:** projektligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (tutje: IFJB) rregullon licencimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve dhe ndërlidhet me shfuqizimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe për Komisionin është i rëndësisë së veçantë, meqenëse ka disa vite që zvarritet kjo çështje. Fjalën ja kaloj Zv.Ministrit Gashi për të na prezantuar projektligjin dhe më pas Guvernatorit që të na jap mendimin mbi projektligjin në fjalë.

**Fatmir Gashi:** meqenëse kemi të bëjmë me një ligj i cili më shumë është i përgaditur dhe i konceptuar nga ana e BQK-së dhe si përgjegjësi ekzekutive e saj për shkaqe të mospërsëritjes së prezantimit të këtij ligji, propozoj t'ia kaloj fjalën Guvernatorit të Bankës Qëndrore.

**Guvernatori:** projektligji ndërlidhet me objektivat e BQK-së i cili ka për qëllim të ngjizë dhe të mbajë një sistem stabil financiar. Arsyeshmëria për këtë projektligj është përmirësimi i infrastrukturës ligjore që ka të bëjë me rregullimin e fushës së operimit dhe investimeve konkrete të IMF-ve dhe IFJB-ve si pjesë e industrisë financiare në vend. BQK-ja me këtë projektligj adreson qartë kërkesën për licencim, qeverisjen adekuate të IMF-ve dhe IFJB-ve, sipas të cilës këto të fundit duhet të veprojnë në përputhje me parimet e pranuar të qeverisjes së mirë për të siguruar. Po ashtu përmes këtij projektligji përcaktohen masat ndëshkuese që BQK-ja mund të ndërmarrë ndaj këtyre institucioneve apo edhe ndaj drejtorëve, menaxherëve të lartë, punëtorëve të tyre si dhe personat që kanë një përqindje të interesit. Përveç tjerash, objektiva që synohen me ndryshime ligjore janë si në vijim: përshtatja e infrastrukturës ligjore me atë të BE-së, avancimi i shërbimeve financiare, përcaktimi i limiteve kreditore për IMF-të me qëllim që të krijohet një diferencë me IFJB-të të cilat merren me aktivitete të kreditimit, rritja e përgjegjësisë në procesin e shqyrtimi, kërkesat për licencim, shtytjen për përzgjedhjen e individëve të aftë dhe të përshtatshëm për të udhëhequr IMF-të dhe IFJB-të, si dhe vetëdijësimi i tyre për instalimin e një fryme në zbatim të ligjit përmes shqyrtimit të masave të ndryshme përmirësuese.

**Kryetari:** me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, nenet 90, 95, 1.6, 110 ,116 të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, janë vlerësuar që nuk janë në

përputhje me Kushtetutën dhe i ka shpallur këto nene si të pavlefshme dhe me aq sa pash unë në këtë projektligj këto nuk janë të përfshira. Pyetja ime është tepër lidhur me rregullimin e mëtutjeshëm të IMF-ve që kanë statusin e OJQ-ve, çfarë ndodh me to? Me aq sa mund të kuptova ato funksionojnë ashtu siç kanë funksionuar deri më tani, dhe në rast se pretendohet ndonjë proces i likuidimit të tyre a rregullohet me këtë ligj apo duhet t'i referohet ndonjë ligji tjetër me theks të veçantë Ligjit të OJQ-ve, pra si e shihni operimin e institucioneve mikrofinanciare që kanë karakter të OJQ-ve dhe si e shihni se duhet zgjidhur kjo çështje? Çështja e dytë ka të bëjë me një vërejtje prej administratës më tepër me çështjen e mosharmonizimit të gjobave me Ligjin për kundërvajtje pra projektligji në fjalë i sheh këto gjopa më të larta?

**Naser Osmani:** Ministria e Financave e ka sponsoruar një projektligj që e ka draftuar BQK dhe ka ardhë tek ne një draftligj me të cilin duhet të ballafaqohemi është një ligj për të cilin asnjëherë nuk kemi mundur me dhënë një përgjigje adekuate.

Ne kemi tentuar me e rregullue veprimtarinë e insitucioneve mikrofinanciare si pjesë e përbashkët e ligjit për bankat, por me të drejtë se Gjykata Kushtetuese ka kërkuar me largu prej këtij ligji, pasi që kemi të bëjmë me një çështje që është e ndërlidhur me Ligjin për OJQ-të.

Ne kemi kërkuar shumë herë që të marrim modele adekuate se si të trajtohet kjo çështje, kemi tentuar edhe tek institucionet tjera dhe rrjedhimisht nuk kemi marrë asnjë propozim në aspektin profesional të qëndrueshëm. Kemi të bëjmë me mjete të cilat janë mjete të donatorëve të dedikuar për Kosovën për qëllime humane dhe këto mjete janë të adresuara përmes mjeteve bankare të cilat në bazë të statusit që kanë institucionet mikrofinanciare si OJQ, e këto bëjnë shërbime komerciale bankare. Me fjalë tjera këto Institucione nuk paguajnë asnjë kontribut, as në ATK e as shteti prej tyre nuk ka asnjë dobi. Konsideroj që këto mjete të shkojnë atje për çka janë të destinuara sepse tendenca e mëhershme që ti fusim në ligj që punëtorët e këtyre institucioneve ti bëjmë aksionarë është e padrejtë.

Kryetar unë besoj që do ta kesh mbështetjen e deputetëve e nëse nuk ke mbështetje politike, sepse bëhet fjalë për 140 milion euro sa kam informata që këto mjete me e përjashtu administrimin e tyre nëpërmjet ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit OJQ dhe ne me e përgadit një ligj i cili ka me i administru këto mjete në forma të ndryshme. Unë konsideroj që çështja e pronësisë mund të tjetërsohet vetëm nëse ke mbështetje politike e nëse jo atëherë ky problem do të përcillet.

**Kryetari:** mjetet në dispozicion prej 121 milion euro, një gjë është e sigurtë që këto mjete nuk guxojnë të transferohen prej OJQ-së në kapital privat për shkak të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe bëjnë mirë që s'guxonë të ndodh një gjë e tillë. Përgjegjësi e jona është që të shohim zgjidhje ligjore për adresimin e këtyre mjeteve, çoftë përmes një fondi zhvillimor apo nëpërmjet politikave të përbashkëta të institucioneve siç është BQK-ja.

**Safete Hadërgjonaj:** kryetar ju e theksuat se Gjykata Kushtetuese ka kthyer mbrapa nenet që e kanë rregullu problematikën e mikrofinancave dhe ne po pajtohemi rreth këtij problemi të mostransferit të neneve, megjithatë mua më vjen mirë që ne prap kemi këtë projektligj në komision sepse jemi ne institucioni që duhet të gjejmë një zgjidhje për këtë problematikë.

Nuk dua ti përsëris ato që i tha Naseri sepse me këtë ligj jemi marrë kohë të gjatë, jemi mundu me gjet zgjidhje dhe s'kemi gjetë, dhe unë dua të besoj se ekziston një vullnet politik për ta gjetur zgjidhjen por edhe i joni në rradhë të parë si Komisionit, sepse ne duhet të japim formën përfundimtare.

Ne jemi përpjekur edhe herave të tjera që të gjejmë një zgjidhje të problemit të mikrofinancave mirëpo kuptohet që bien në kontraditë me Ligjin për OJQ-të, mirëpo tash projektligji për OJQ-të është në Kuvend duke u punuar në Komisionin për Administratë Publike dhe mendoj se është mirë që ne të mbajmë një takim të përbashkët me atë komision, në mënyrë që bashkarisht të gjejmë zgjidhjen meqenëse kemi të dy projektligjet në procedurë dhe besojë se të gjithë, si pozita edhe opozita, Qeveria dhe Kuvendi jemi të interesuar ta gjejmë këtë zgjidhje.

Naseri e theksoi se mjetet janë marrë si donacione, mirëpo nëse e analizojmë se a janë destinuar këto mjete për këtë formë lënë shumë për të dëshiruar sepse nga mikrofinancat të jepen kredi me kamatë 23% siç kemi parë në raportin e BQK-së nuk është e logjikshme! Kush i merr këto kredi? I marrin krejt shtresat e varfëra të shoqërisë sonë, njerëzit të cilët kanë nevojë për ekzistencë i marrin këto me gjithë këto kamata të larta e rrjedhimisht është e pamundur ti kthejnë me këto norma të larta.

Këtu ka mendime dhe qëndrime të ndryshme të individëve dhe të institucioneve joqeveritare dhe qeveritare, mirëpo një institucion që krijon profit nuk është e logjikshme ta ketë statusin e një institucioni joprofitabil dhe nuk i paguan asnjë gjë shtetit të Kosovës për profitin që realizon, dhe kjo është një problem sepse para syve tanë kanë ndodhur të gjitha këto gjëra, prandaj kemi ardhur këtu dhe uroj ta gjejmë një zgjidhje bashkarisht.

**Hykmete Bajrami:** këtu jam për dy arsye, e para që kur ka ardhë ligji për mikrofinanca në vitin 2012 unë i kam takuar këtij Komisioni dhe kam qenë kundërshtarë e atij ligji, gjithashtu edhe grupi ynë parlamentar. Ndërsa tani shpreha interes me shiku projektligjin dhe pash ka ndryshu por jo në fakt në esencë. Ajo që besoj që po pajtohem të gjithë përfundimisht është se statusi i këtyre institucioneve duhet të ndryshojë sepse institucionet profitabile duhet të paguajnë tatim dhe nuk mund të marrin fitime të mëdha dhe njëkohësisht të mos paguajnë tatim shtetit.

Ky projektligj është shumë më i sofistikuar, mirëpo gjithsesi prap në një farë forme po i bën pronar të kapitalit i cili është formuar në mënyrë jo të ligjshme për shkak se siç e thamë institucionet financiare si janë krijuar me qëllime bamirësie në bazë të ligjit për OJQ-të dhe janë të regjistruara pranë Ministrisë së Administratës Publike, ndërkohë që interesat për kreditë e lëshuara kanë qenë 23-32 % në periudhat e ndryshme.

Nëse e shohim nenin 13 të draftligjit këtu është ajo ku thuhet se IMF-të dhe IFJB-të si persona juridik mund të investojnë në pronësi të një institucioni financiar dhe të bëhen aksionar të një institucioni financiar e cila nënkupton se nuk po flasim për një transfer klasik të cilin e kemi thënë në vitin 2012, por po ju themi me këto 120 milion asete, ju mund të bleni aksione në institucione financiare dhe ky nen duhet të fshihet.

Ndër të tjera gjithashtu në nenet paraprake, këtyre institucioneve i është lejuar marrja e dipozitive, qe po ashtu rritë kredidhënien nga 25.000 në 50.000 dhe ne e dimë se në Ligjin e Bankave thuhet se maksimumi që mundet me e lëshu kredi IMF-të është 25.000 dhe nuk është 50.000, sepse këto e kanë klientelën e caktuar pra ju shërbejnë personave dhe institucioneve të cilat nuk i përmbushin kushtet për të marrë kredi në një bankë, e ne nuk mundemi të lejojmë një institucion ose individ i cili nuk i përmbush kushtet për të marrë kredi në bankë të shkon dhe të mbytet në borxhe në IMF.

Mendoj se gjithsesi ne duhet ta zgjidhim këtë problem dhe gjithashtu besoj që ka alternativa për ta zgjidhur. P.sh një prej tyre është që komplet kapitali i cili është krijuar nga donacionet me qëllime bamirësie, të shfrytëzohet për qëllime bamirësie e asesi një kapital i dhuruar nga donatorë të ndryshëm dhe i krijuar në bazë joligjore siç e thamë duke e ngarkuar me interesa deri 30% tu lejohet që dikujt të investojë në institucione tjera financiare dhe të bëhen aksionar jo të këtyre që i kanë por edhe institucioneve tjera. Më lejoni të them që ka përvoja jo në vendet e BE-së se vendet e BE-së kanë një nivel të mirë të zhvillimit ekonomik dhe atje nuk ekzistojnë këto institucione, por ka vende të cilat janë në zhvillim ekonomik, p.sh Banka e Bangladeshit ka qenë një IMF dhe kur ajo është shëndrruar në Bank, aksionar ka bërë të gjithë njerëzit të cilët kanë marrë kredi nga ai IMF, ata që kanë kontribuar në rritjen e kapitalit të këtyre institucioneve janë ata që kanë paguar interesa 30% dhe jo të tjerët.

Mendojë që kapitali mund t'iu kalojë institucioneve tjera, OJQ-ve tjera për qëllime bamirësie, dhe tjetra është pse jo të gjithë huamarrësit që kanë marrë hua nga këto institucione të bëhen aksionar, ata mandej të vendosin nëse dojnë ti shesin këto aksione ose jo por asnjëherë nuk do të kalojë një ligj në Kuvendin e Republikës së Kosovës ku lejon persona të caktuar të cilët deri dje kanë marrë paga nga 10.000 euro në muaj dhe ju i keni raportet e dini dhe sot të krijohen në aksionar të këtij kapitali të krijuar në mënyrë komplet të paligjshme.

**Fatmir Gashi:** pajtohem plotësisht me atë që po e thuhet në lidhje me OJQ-të të regjistruara si mikrofinanca, mirëpo duhet me pas të qartë se OJQ-të janë të regjistruara si mikrofinanca që në kohën e UNMIK-ut. Ato janë në menaxhim të BQK-së e me atë do të merret vet ajo. Kryetari e shtroj çështjen e dënimeve dhe ligjit për kundërvajtjeve, po ashtu Ministria e Drejtësisë ka shtruar të njëjtën pyetje dhe përgjigja është që kur ligji përcakton përgjegjësitë e caktuara për një degë e për një institucion financiar nuk merret për bazë ligji për kundërvajtje dhe ne e kemi shtu një pasues në nenin 27 ku thojmë “shkeljet ,dënimet dhe masat e përmirësimit të paraparë në këtë nen nuk janë objekt i rregullimit të ligjit për kundërvajtje”. Mikrofinanca mundet me qenë edhe shoqëri aksionare, mundet me qenë forma e organizimit të saj e ndryshme dhe ky ligj që është sot në diskutim me përkufizime të jep çka është IMF dhe IFJB, ato që kanë ekzistuar nuk i lejon ky kurrfar transformimi ato mbesin me regjistrim adekuat siç janë sot dhe ne nuk jepim këtu zgjidhje të transformimit të tyre.

**Kryetari:** Guvernator kemi një gjendje faktike që një pjesë e mikrofinancave janë OJQ dhe një pjesë e ligjit i referohet transformimit të licencave në ligjin e ri dhe flet për obligimet dhe detyrimet regjistruese që i kanë. Më intereson mendimi juaj për çështjet që i ngritën deputetët , çfarë janë qëllimet e BQK-së në këtë drejtim?

**Guvernatori:** pajtohem me atë që e përmendi znj.Hadërgjonaj, që kjo çështje duhet të rregullohet me Ligjin e OJQ-ve sepse një ligj i tillë rregullon veprimtarinë e OJQ-ve, andaj edhe çështja e transformimit si dhe procesi i likuidimit të gjitha këto është mirë të rregullohen me këtë ligj. Sa i përket projektligjit aktual tek kërkesat për licencim dhe siguri mundeni me pa që e kemi lënë mundësinë që mund të regjistrohen IMF-të vetëm ato që janë të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, pra OJQ e reja të cilat nuk e kanë statusin nga ana e Ministrisë përkatëse në fjalë nuk mund të regjistrohen. Për këto ekzistuese është mirë që paralelisht me ligjin e OJQ-ve të rregullohet dhe të parashihet procesi i likuidimit ose i transformimit të këtyre IMF OJQ-ve.

**Hykmete Bajrami:** zoti Guvernator a mund të ma shpjegoni se a janë IMF OJQ të regjistruara pranë Ministrisë së Administratës Publike subjekt i këtij ligji, sepse ne kemi kuptuar që ky ligj rregullon edhe ato? Besoj se duhet ta shtojmë një nen se ky ligj nuk rregullon IMF të regjistruara si OJQ?

**Safete Hadërgjonaj:** nëse ne ua lëjmë emrin e njëjtë mikrofinancave që regjistrohen sipas këtij ligji dhe kemi edhe mikrofinancat të cilat funksionojnë si OJQ me status të benificuar, atëherë çfarë zgjidhje po bëjmë këtu, këtu spo e bëjmë kurrfarë zgjidhje?

**Fitore Neziri:** theksoi se ky projektligj nuk adreson procesin e mikrofinancave OJQ në raport me transformimin e tyre por adreson të gjitha IMF dhe IFJB, qoftë OJQ, qoftë në statusin e shoqërive biznesore, në aspekt rregullimit, mbikëqyrjes dhe licencuesve, por jo në aspekt transformimi. Duke qenë se Ligji për OJQ-të si ligj special i cili determinon këtë fushë specifike, ne duke e pasur edhe përfaqësuesin e OJQ-ve kemi ardhë në përfundim që çështjet që kanë të bëjnë me transformimin të mos adresohen fare me këtë projektligj sepse ndryshe do të binim ndesh me parimin e qeverisjes dhe aktet e Gjykatës Kushtetuese. Dua të ndërlihem me pyetjen e Znj. Bajrami, kjo është një shtyllë plotësisht e kundërt prej transformimit për të cilin është fol paraprakisht sepse ne kemi lejuar me këtë ligj investimin në shoqëritë biznesore por me qëllimin që kthimet e investimit, dividendat përkatëse asesi mos të shkojnë për përfitime individuale dhe komerciale, por të mbesin për përfitime publike, praktikat e tilla ekzistojnë në të gjithë botën dhe shembull kemi Gjermaninë.

**Naser Osmani:** BQK-ja në bazë të ligjit a i kontrollon mikrofinancat e OJQ-ve, nëse i kontrollon pse e keni përjashtuar atëherë çështjen kryesore? Nëse ju i kontrolloni ju keni obligim me bo propozime?

**Hykmete Bajrami:** e para është që në komplet projektligjin nuk thuhet se ky ligj nuk trajton IMF-të të regjistruara si OJQ. E dyta keni lejuar në nenin 13 investim të kapitalit, andaj pyetja është kështu a ju lejohet edhe mikrofinancave si OJQ me investu në institucione financiare? Prej vitit 2012 keni pas kohë me rregullu këtë ligj dhe nuk i keni adresu çështjet kryesore?

**Kryetari:** sa për qartësim jemi në fazën e diskutimeve dhe në qoftë se duhet edhe e kthejmë prapa edhe ligjin, nëse e shohim se një i tillë nuk rregullon atë që thirret për të prezantuar. Mua më intereson të dijë përgjigjen e Guvernatorit për çështjen që u ngriten rreth fushëverimit, rregullimit të këtij ligji dhe çështjes së investimeve të kapitalit të IMF-ve?

**Guvernatori:** përsëris edhe një herë se kjo çështja e transformimit nuk rregullohet me këtë ligj dhe derisa mundemi me e kthi këtë ligj disa herë mbrapa ky nuk e rregullon, është provuar në vitin 2012 mirëpo Gjykata Kushtetuese e ka hudhur poshtë andaj çështja e transformimit mund të rregullohet me Ligjin e OJQ-ve. Ne jemi për me rregullu, për me transformu dhe të mos lejohet që të vazhdohet tutje që këto IMF me funksionu në këtë verzionin aktual. Sa i përket pyetjes së zotit Osmani, ne i mbikëqyrim të gjitha IMF-të.

**Naser Osmani:** nëse BQK-ja ka për obligim me i rregullu dhe me i mbikëqyrë IMF-të, atëherë BQK-ja duhet ti japë propozimet e veta sepse me 120 milion ka ndërhyrje në sistemin financiar bankar dhe nëse ne mburremi se kemi stabilitet financiar sepse të gjitha bankat janë likuide, atëherë pse lejohet një ndërhyrje me një shumë kaq të madhe në këtë sistem bankar. E keqja e kësaj është se përmes OJQ-ve këta i shmangin obligimet tatimore ndaj shtetit dhe janë shumë vite që janë duke vepruar kështu andaj ne kemi prit propozimin si me zgjidh këtë problem. Propozoj që të bëhet një grup punues që këtë draftligj ose duhet me plotësu ose duhet me bë një zgjidhje tjetër.

**Hikmete Bajrami:** ne nuk duhet ti ikim qëllimeve të bamirësisë të cilat i kanë OJQ-të, nëse u tha për rastin e Gjermanisë si ka mundësi që BQK-ja i ka mbikëqyrë në aspektin financiar këto institucione dhe kanë lejuar që këto institucione të paguajnë paga drejtorëve ekzekutiv deri në 10.000 euro, në të njëjtën kohë me pas statusin e beneficuesit mos me i pagu tatime shtetit dhe me dhënë kredi me norma të kamatës deri në 32%, cili është roli i juaj në këtë mes sepse nuk e kam të qartë? Cilët mekanizma i keni ju që këto dividenda të shfrytëzohen për qëllime bamirësie, sepse deri më sot asnjë lloj bamirësie nuk ka ndodh. Ju e dini që shtresa e varfër nuk janë kualifikuar me i marrë paratë në banka dhe kanë marrë para me fajde në këto institucione.

**Fatmir Gashi:** ky ligj nuk ka qëllimi dhe nuk ka drejtë për rregullimin e OJQ-ve sespe e ndalon akgyrkimi i Gjykatës Kushtetues dhe duhet një ligj plotësisht i ri. Kjo punë është prej 1999 pajtohem se është krejtësisht joligjore, por ne duhet me nxerr një ligj që e rregullon këtë çështje dhe që është në harmoni me Ligjin për OJQ-në dhe Kushtetutën.

**Safete Hadërgjonaj:** zv.ministër kam disa pyetje, sa ka logjikë ekzistimi i Mikrofinancave si OJQ që nuk paguajnë tatim shtetit dhe ekzistimi i mikrofinancave si mikrofinanca që i paguajn tatim shtetit?!, Tjetra, meqenëse kemi përfaqësuesit e BQK-së, ne kemi pa edhe në raportin e fundit që është regjistru edhe një mikrofinancë, a është regjistru si OJQ? A ka pas mikrofinancë të regjistruar vetëm në kohën e UNMIK-ut apo janë regjistruar edhe më vonë dhe ato munden me u regjistru edhe më tutje?

**Guvernatori:** IMF-të dhe IFJB-të si persona juridik mund të investojnë, dhe nëse lexojmë nenin 1 paragrafi 14, përjashtohen OJQ-të, unë po e shoh që ka polemika të ndryshme pse BQK-ja nuk po jep alternativa, alternativën e dhamë dhe nëse keni vullnet politik e rregullojmë. Kjo rregullohet me ligjin e OJQ-ve dhe ndalojeni me u marrë me veprime të tilla. Në ligjin e OJQ-ve me vendos procesin e

transformimit dhe likuidimit të OJQ-ve, kemi një agjension që i mbikëqyr OJQ-të është në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike dhe pse ky agjension nuk ja merr statusin e benificionit publik?

**Lulzim Rafuna:** lidhur me transformimin e IMF-ve OJQ, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e ka ndaluar që ky ligj nuk guxon me u përzie në dispozita të Ligjit për OJQ, dhe aty thuhet se në qoftëse doni me e ndryshu çështjen e OJQ-ve duhet me ju drejtu ligjit për OJQ. Ndërsa ky ligj nuk lejon që Organizatat Mikrofinanciare me mbledh depozita. Çështja e gjobave e tha edhe zëvendësi se ky është ligj i veçantë kundrejt ligjit të përgjithshëm për gjoba, dhe ky ka përparësi në aplikim.

**Ali Lajqi:** në bazë të konsulacionit juridik kushtetues bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, kjo pjesa që u trajtu këtu është se ky ligj trajton mikrofinancat, kurse OJQ-të janë me një ligj tjetër. Prandaj përpjekjet për me gjetë këtë problem është një vullnet i mirë, por nuk lejon Kushtetuta që të përzihen këto dy çështje bashkë me një ligj.

**Kryetari:** unë i dëgjova të gjitha komentet, propozimet këtu dhe mund të them se ka një vullnet për me përmirësu këtë problem si dhe ka disa paqartësi në ligj dhe mbi të gjitha çështja kryesore mbetet e 120 milionë eurove të aseteve të IMF-ve të cilat nuk marrin adresë finale për çështje të ndryshme. Propozoj idenë e formimit të një grupi punues dhe ky grup punues të nisë një sërë takimesh me Komisionin për Administratë Publike dhe të dy projektligjet të trajtojnë në të njëjtën kohë.

Kemi një gjendje të krijuar pas luftës pra kemi institucione OJQ që kanë 120 milionë euro kapital që bëjnë profit dhe drejtorat e të cilëve marrin paga 10.000, 20.000 apo edhe 30.000 euro në muaj dhe në anën tjetër kemi një ligj i cili nuk jep zgjidhje përfundimtare për adresimin e tyre. Po të pyetsha unë këto institucione do të shkonin drejt falimentimit dhe paratë e marra do të adresoheshin në çështje bamirësie ose në një fond zhvillimor ose do të shkonin në ndërtimin e spitaleve pra për çka janë destinuar prej fillimit. Propozoj që grupi punues të përbëhet nga: Lumir Abdixhiku (kryesues), Safete Hadërgjonaj dhe Naser Osmani.

Kryetari konstatoi se Komisionit njëzëri miratoi propozimi për krijimin e grupit punues, me këtë përbërje: Lumir Abdixhiku (kryesues), Safete Hadërgjonaj dhe Naser Osmani.

Pas diskutimeve kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë:

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-072 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

#### **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale**

**Kryetari:** pika e rendit të ditës nr.4, 5 dhe 6 janë projektligje, respektivisht ndryshime dhe plotësimet të ligjeve fiskale, për të cilat ia kaloj fjalën zv. ministrit në qoftë se keni për të na thënë diçka në lidhje me këto ndryshime.

**Fatmir Gashi:** ju njoftoj se Komision në kuadër të Ministrisë është duke punuar në draftimin e koncept dokumentit për ndryshimin e këtyre tre ligjeve dhe Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat. Komisioni e ka përfunduar koncept dokumentin dhe janë formuar komisionet tjera për vazhdimin e punës në lidhje me këto tatime. Ne nuk jemi kundër këtyre propozimeve dha ato janë të inkuorpuara tani me këto propozimet e reja. Për mos me i vë shumë ndryshime dhe plotësime të këtyre ligjeve ne kemi kriju projektligje të reja të cilat janë të kryera dhe vazhdon procedura ashtu siç është e paraparë me rregullat

mbi nxjerrjen e ligjeve. Këto draftligje parashohin shumë më shumë se këto ndryshime që përfshihen këtu dhe ne mendojmë se nëse fillojmë tash dhe i ndryshojmë nen për nen na del neve me ndryshu për çdo muaj.

**Safete Hadërgjonaj:** të them të drejtën edhe ne në Komision tash jemi në një situatë të palakmueshme me këto projektligje. Këto çka i tha zv.ministri i kemi parë edhe në një shkresë e cila është adresuar Kuvendit me kërkesën që i është bërë Qeverisë sipas rregullave procedurale. Kam theksuar disa herë që që është problem kur një ligj po ndryshon 10 herë, p.sh e kemi Ligjin e menaxhimit e financave publike, që është ndryshuar pesë herë.

Unë e vlerësoj çdo ndryshim dhe plotësim të ligjit që janë në funksion të përkrahjes së investimeve edhe investitorëve të huaj edhe vendor, dhe i cili bëhet për ta stimuluar prodhimtarinë vendore në mënyrë që të kemi prodhimtari më të madhe, plotësim më të madh të nevojave me produkte vendore, e kështu të krijohen kushte edhe të eksportit të prodhimeve vendore në mënyrë që të ulim edhe diferencën e madhe të raportit të importit dhe eksportit. Megjithatë, meqenëse ligjet e reja janë në prag të ardhjes në Kuvend dhe ministria konstatoi se përveç ndryshimeve tjera, janë edhe këto propozime, dhe ne do ti shofim dhe diskutojmë, dhe do të doja që projektligjet të na vinin para qershorit, të shqyrtohen e të miratohen para se të shkojë Kuvendi në pushim në mënyrë që mos të na bie të merremi me këto projektligje kur jemi duke u marrë me rishikim të buxhetit. Kështu që kërkoj edhe mirëkuptim prej Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, në mënyrë që ti presim ligjet dhe pjesë e tyre të jenë edhe këto propozime.

**Lulzim Rafuna:** në fakt janë tri propozimet që janë shumë të mira dhe i kemi marrë për bazë, mirëpo me mirëkuptim kishim kërku që ti presim edhe projektligjet që do ti sjellim sepse nuk do të ishte një mesazh i mirë për bizneset dhe investitorët në qoftëse ne për çdo muaj shkojmë me plotësim ndryshime të ligjit. Ligjet që do të vinë nuk do të vinë plotësim-ndryshime por do të vinë projektligje për arsye se ka shumë ma shumë substancë, por që për administratën dhe biznesin paraqesin një sfidë për shkak të ndryshimeve të shpeshta për me t'iu adaptuar.

**Kryetari:** po e shoh që nuk ka ndonjë kundërshtim në lidhje me këto projektligje dhe po e hudh në votim.

Pas përfundimit të diskutimeve kryetari konstatoi se Komisioni me tri vota për, dy kundër dhe një abstenim, nxori këtë

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

### **5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-044 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave**

**Kryetari:** po e shoh që nuk ka ndonjë kundërshtim në lidhje me këto projektligje dhe po e hudh në votim.

Pas përfundimit të diskutimeve kryetari konstatoi se Komisioni me tri vota për, dy kundër dhe një abstenim, nxori këtë

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.



## **6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-043 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar**

**Kryetari:** po e shoh që nuk ka ndonjë kundërshtim në lidhje me këto projektligje dhe po e hudh në votim.

Pas përfundimit të diskutimeve kryetari konstatoi se Komisioni me tri vota për, dy kundër dhe një abstenim, nxori këtë

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar.

## **7. Tatimi me Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit për realizimin e planit të të hyrave, për tremujorin e parë të vitit 2018**

**Kryetari:** ju kisha lut nga një prezentim të shkurtë nga ATK-ja në lidhje me procesin e monitorimit për realizimin e planit të të hyrave, për tremujorin e parë të vitit 2018.

**Sakip Imeri:** ATK-ja është institucioni që ka aktualisht 812 staf, nga kjo strukturë 535 janë meshkuj apo 68.5% dhe 247 femra apo 31.5%, dhe në aspektin e strukturës etnike 95% janë shqiptarë, 4% serb, 0.3% turq dhe 0.8% të tjerë, ndërsa në aspektin e strukturës kualifikuese prej këtij stafi 89% janë me përgatitje superiore, 1.2% me përgatitje të lartë dhe 9.7% me përgatitje të mesme. Në tremujorin apo katër mujorin e kaluar, në secilin muaj kemi tejkalim të planit për 11 milionë, përkatësisht 21 milion më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në pjesën e të hyrave merr pjesë me 47.5% tatimi mbi vlerën e shtuar, 23.3% tatimi në të ardhurat e korporatave dhe me 29.2% tatimi në të ardhurat personale, normat e ulëta në tatimet direkte e krijojnë këtë mundësi që kjo strukturë të jetë 47.5% tatimi indirekt ndërsa 52.5% tatimet direkte.

Këtë tre mujor janë realizu 376 kontrolla. Një fushë e debatueshme dhe shqetësuese vazhdimisht janë paisja e bizneseve me arka fiskale ku ne kemi shënuar rezultate jashtëzakonisht të mira përkundër që nuk është arrit e tëra, kemi një situatë që mbi 28.000 tatimpagues janë të fiskalizuar dhe një numër i madh i paisjeve më moderne fiskale raportojnë çdo ditë, ndërsa një numër i arkave fiskale që janë pajisë më herët raportimin e kanë 1 mujore dhe në bazë të këtyre të dhënave ne pastaj i zhvillojmë edhe aktivitetet në terren. Gjithsej, janë 37.245 paisje elektronike fiskale.

Procesi i fiskalizimit të një kategorie të veçantë me kosto më të lartë është zgjedh me një konkurrencë mjaft të mirë që ofrojnë paisje specifike për derivatet e naftës ku procesi aty është i përfunduar, posaqërisht për bizneset që operojnë te tatimpaguesit e mëdhenj dhe që sjellin të hyrat nga kjo kategori mbi 90% e të hyrave të derivateve janë nga kategoria e tatimpaguesve të mëdhenj. Një fushë tjetër për të cilën ka sigurisht propozime në ligjet aktuale që janë duke u draftu është pjesa e borxheve, që është një sfidë për ATK-në edhe nga vitet e kaluara, mirëpo edhe këtu ka rezultate ku trendet janë pozitive edhe në të hyra edhe në aktivitetet tjera që është përgjegjësi e ATK-së. Sa i përket çështje tjetër me rëndësi është çështja e rimbursimeve tatimore edhe për bizneset dhe rimbursimi i qytetarëve një metodë e nxitjes për marrjen e kuponëve fiskal e cila ka pas një formë tjetër nga viti i kaluar.

**Kryetari:** kam disa pyetje besoj me interes edhe për publikun dhe më e rëndësishmja ka të bëjë me numrin e inspektorëve dhe me sa e kam parasysh për kokë të banorit e keni numrin më të ulët të inspektorëve pra a mund të bëjmë ne ndonjë gjë si Komision për hartimin e proceseve buxhetore për me e rrit këtë numër të inspektorëve? E dyta çështja e arkave fiskale për naftarë kur përfundon si proces?

Dhe e treta rimbursimi i kuponave fiskal kjo metoda e re, a është më e suksesshme sesa paraprakja, jo për nga menaxhimi, por për nga një far lloj inspektimi të deleguar që i bëhet qytetarëve me vetë interesin për mbledhjen e kuponëve, të paktën prej një përceptimi krejtisht amator dhe qytetarë po e shoh që njerëzit nuk po i mbledhin më kuponat në atë masë sa më herë, pra a keni bë mirë që e keni ndryshu këtë praktikë, në qoftë se jo a kish qenë ndoshta më mirë me e rrit kapacitetin për me menaxhu të njëjtën praktikë, por me mbajtë trendin e interesimit sepse jo pak vende qytetarët e kanë luajtur rolin e inspektorit duke kërkuar mbledhjen e kuponëve fiskal? Çështja e katër si e vlerësoni bashkëpunimin me Doganën e Kosovës?

**Naser Osmani:** a ka kapacitete ATK për mbledhjen e TVSH-së brenda vendit dhe që mos të rrezikohet buxheti i Kosovës? Kërkojë një sqarim në faqen 12, që flitet për koston e vlersë së investive? Si dhe pyetja e tretë ka të bëjë me atë që kemi bisedu më herët është që me rikthy organin e shkallës së dytë të Bordin për shqyrtimin e ankesave tatimore në procedurën administrative?

**Safete Hadërgjonaj:** ne jemi të vetëdijshëm që ju jeni dy institucione shumë të rëndësishme që nga ju varet edhe fati i Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe jemi të vetëdijshëm që ju i raportoni Qeverisë dhe Ministrin të Financave. Ne në Komisionin kemi pas marrë një qëndrim që të diskutojmë të paktën një herë në vit për trendin e të hyrave dhe për vështirësitë me të cilat përballeni ju si dy institucione, por pasur nevojë për ndonjë rekomandim në drejtim të Kuvendit për raportin tuaj tremujor. Kryesisht është raportim në Komision për me pas më shumë informata për tu njohur me problemet dhe vështirësitë me të cilat përballen këto dy institucione mjaft kredibile dhe me interes për tu trajtuar mirë si dhe ju me punu mirë në mënyrë që të mbushim buxhetin me mjete.

Së pari kjo tabela tek personeli s'më pëlqej fare sepse 288 janë më shumë burra të punësuar në ATK në krahasim me gra dhe jam e bindur që ky proporcion të ishte më i përafërt me gratë ky raport do të ishte shumë më i mirë sepse edhe vajzat edhe gratë kanë përgaditje të lartë shkollore.

Ju përgëzoj për trendin pozitiv por e kam diskutu edhe me drejtorin e ATK-së se janë pak shqetësuese kjo puna e arkave fiskale, kuptohet që biznesi në Kosovë ka fillu me u zhvillu nuk kemi pas traditë të mirë të pagesës duke marrë parasysh që bizneset kanë fillu prej viteve 90 deri në vitin kur ka fillu lufta nuk kanë qenë shumë të disponuar me i pagu tatimet në ish sistemin, megjithatë ne duhet me qenë shumë serioz në këtë drejtim që ti fusim bizneset në sistem dhe asnjë biznes të mos mbetet pa i kry obligimet e veta. Ndoshta përcjellja e këtij sistemi bëhet edhe përmes arkave fiskale, unë nuk e di a keni ju në ATK ndonjë mekanizëm që e kontrollon biznesin i cili e ka marrë arkën fiskale e po i njëjti nuk e përdor? Po flas nga përvoja ime ku në komunën prej të cilës vijë unë mundem me thënë se në total janë dy apo tre vende që më lëshojnë kupon fiskal, vendet tjera gjejnë arsye të ndryshme për mosdhënien e kuponit e kjo për mua është tepër shqetësuese, nuk është në rregull që disa biznese përdorin arkën fiskale e disa jo kjo mundet me e kriju edhe një lloj konkurrence e pabarabartë në mes tyre!

Ju thatë se 28.000 tatimpagues janë të fiskalizuar por sa prej këtyre nuk paguajnë tatim, pra se përdorin fare arkën fiskale? E diskutoj edhe kryetari çështjen e kuponave fiskal e cila thuhet rrallë po e shoh që po mbledhin kupona fiskal pas ndryshimit të formës së kompensimit, ose kemi rastin tjetër kur furnizohem me karburant të cilët thonë nuk ekziston mundësia ata me e lëshu kuponin fiskal, përderisa nuk ja kërkon vet. Tek lojërat e fatit ne kemi hartuar ligjin për lojrat e fatit, por nuk po e di sa është funksional? Ne jemi në dijeni që nuk po funksionon mirë ky sistem dhe më bëri përshtypje ky numri i gjobave në periudhën raportuese, a kishit mundur me na tregu çka keni gjet më shumë gjatë kontrollimit të tyre për shkak që kemi raste që shkaktojnë fatalitetit janë pikërisht këto lojëra?

**Sakip Imeri:** deri më 31 mars, janë 782 të punësuar, ndërsa nga java e kaluar kemi edhe 30 zyrtarë tjerë dhe arrijmë në numrin 812, ndërsa me buxhet janë lejuar 824. 10% e të të punësuarve janë me probleme shëndetsore, ndërsa 312 inspektorë të cilët janë përgjegjës tatimor direkt me tatimpaguesit, ATK-ja nuk ka kapacitete të mjaftueshme për me i menaxhu të gjitha proceset.

Për çështjet e lëshimit të kuponëve fiskal, paisjet fiskale raportojnë një herë në ditë eventualisht një herë në muaj dhe për tatimpagues që nuk raportojnë ne kemi veglat që i vëzhgojmë dhe ndëshkojmë.

Tek fiskalizimi i naftëtarëve mbi 90% e të hyrave që krijohen nga naftëtarët janë tatimpagues të mëdhenj pra janë të fiskalizuar 100%, janë 646 paisje për derivate të naftës që janë të vendosura dhe nuk ka mundësi që biznesi i fiskalizuar të derivateve të naftës pa e shtyp edhe kuponin fiskal, ndërsa marrja ose mosmarrja e kuponit fiskal është çështje e dy palëve edhe atij që e lëshon edhe e atij që e merr.

Rimburesimi për kupon fiskal ka qenë një formë jashtëzakonisht e mirë por shumë e mundimshme për ATK, por e menaxhueshme dhe diku mbi 1.5 milionë qytetarë kanë qenë përfitues ku prej qershorit të vitit të kaluar ka ndërruar forma ku mundësia maksimale e rimburesimit është 4500 qytetar potencialisht secili që ka dorëzuar pliko ka qenë edhe fitues.

Te pjesa e TVSH-së në brendi ne kemi edhe një test nga viti 2015 kur bizneset që prodhojnë e gëzojnë zbritjen e TVSH-së në importe që ta paguajnë pastaj kur ta përpunojnë lëndën e parë dhe e shëndrrojnë për produkt final, ne kemi krijuar një komision që po e menaxhon por realisht është sfidë por edhe e mundshme.

Tek pyetja e kostove të vlerave për njësi është një çështje që ndoshta nuk e kemi sqaruar mjaftueshëm ku shpenzimet e ATK-së janë shpenzimet buxhetore që krijohen përballë të hyrave që i vjel ATK-ja janë tatimet dhe kontributet pensionale për shkak se përgjegjsia e ATK-së është edhe vjelja e kontributeve pensionale.

Sa i përket çështja e borxheve për rishqyrtime ne e shohim një pengesë kalimin në divizionin fiskal krejt për një arsye të thjeshtë se nuk kemi kohë të mjaftueshme do të thotë vonesat e vendimeve që i sjell gjykata, respektivisht divizioni fiskal, ndoshta sillen aq me vonesë dhe për çështje të rikthimit në procedurë asnjë vendosje pozitive nuk është e favorshme për ta. Në këtë drejtim rikthimi i bordit është një lehtësi për tatimpaguesit dhe është lehtësi edhe për eliminimin e gabimeve që mundet me i bë ATK-ja dhe Doganës. Ne kemi bërë propozimet tona tani kur është duke u punuar Projektligjit i ri për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Sa i përket gjinisë ne kemi bërë përpjekje me e rrit strukturën gjinore nga vetëm mandati im është dikund rreth 0.8% është rrit ndërsa së fundmi është një proporcion 53% mashkuj 47% femra. Tek lojërat e fatit është pjesa më kritike për ATK-në, kryesisht mangësitë janë tek respektimi i distancave që i ka përcaktu ligji. Bashkpunimi i ATK-së dhe Doganës është i mirë.

**Kryetari:** ju kisha lut nga një prezentim të shkurtë nga Dogana në lidhje me procesin e monitorimit për realizimin e planit të të hyrave, për tremujorin e parë të vitit 2018.

**Bahri Berisha:** raporti tremujor i Doganave përfshin performancën që ka ndodh gjatë këtyre tre muajve si dhe politikat fiskale ku kemi një ngritje të madhe të taksës në kufi. Në fakt viti i kaluar u mbyll pozitivisht dhe 1.37% apo diku rreth 113 milionë të hyra më shumë se viti i kaluar. Në vitin 2018 projeksioni për DK-në është 1.175.000.000 euro në krahasim me vitin paraprak është një rritje prej 6 % apo 67 milion më shumë se viti paraprak. Projeksioni për këtë tre mujor ka qenë 221 milionë ku DK-ja deri me 31 mars ka arrit me i mbledh 211 milion, dhe është një ditë minus për shkak se ka qëlluar vikend dhe në total 214 milion euro apo 96% e planit tre mujor. Në këtë tre mujor kemi pas një përmbyllje me 4.1 milionë më shumë krahasuar me tre mujorin e vitit të kaluar apo 2.1%, por jemi mbrapa për një përqindje të caktuar.

Taksa doganore ka shënuar rënie për shkak të ndikimit të MSA-së, kufizimi i importimit të vjetërsisë së veturave, dhe politikave fiskale një pjesë e këtyre taksave që mbledhen në kufi. Efekti është pritur që në afatshkurtër të jetë negati, ndërsa përfitimet priten në afatgjatë. Si rezultat, kemi pasur rreth 26 milion euro më pak të hyra për këtë tremujor. Në kuadër të strukturës së të hyrave, TVSH-ja merrë pjesë me 52%, akciza me 37% dhe 11% taksë doganore. Efekti negati i të hyrave është rreth 12%. Një pjesë do të kompensohet nga sasia e importit më të madhë të derivateve. Efekti negativë i të hyrave deri në fund të vitit do të jetë më i lartë, edhe për faktin e lirimeve për prodhuesit pa numra tarifor dhe pa kategori të mallrave.

**Kryetari:** më intereson të dijë sa i shihni të realizueshme projeksionet fundvitit, sepse bazuar në trendet e tremujorit të parë, të dhënat janë shqetësuese, 10 milion euro janë më pak se vitin e kaluar dhe deri në fund të vitit mund të kemi 40 milion euro më pak, pra a keni një matje si do të del në fund? Çështja e dytë që më intereson është funksionimi i Doganave në Veri 1 dhe 31, a keni probleme atje? A funksionojnë normalisht doganierët?

**Bahri Berisha:** në bazë të analizave tona, ndikimi total negativë të hyrave do të jetë 70 milion euro apo 6% më pak. Vetëm kufizimi i vjetësisë së veturave, do të ketë efekt negativ prej 40 milion euro, që është ndikimi më i theksuar. Ne presim që nuk do të ketë më shumë të hyra nga taksa për vetura se 45-50 milion euro. Si rezultat i vendimit që ka hyrë në fuqi nga prilli, për lirimet e paisjeve të IT-së dhe pjesë rezervë të makinerive prodhuese, presim të ketë ndikim negativ 30-35 milion euro. Ndërkaq, si rezultat i politikave fiskale, kemi dikun 55 milion euro lirime nga tatimet doganore apo 8% më pak në total. Dogana është prezent në dy pikat kufitare në Veri, të gjitha procedurat, kontrollet dhe sistemet doganore janë të ngjashme si në vendet tjera. Nuk jemi prezent në patrullimet në anët malore, në qytetin brenda Mitrovicës së Veriut, për shkak të sigurisë. Por bëjmë hetime dhe kontrabanda ka rënë dukshëm. Doganiert funksionojnë normalisht, me vetura dhe me orar të plotë. Bashkëpunimi është i mirë me ATK, por edhe me insitucionet tjera, si Policia, AVUK-u.

Kryetari konstatoi se në mungesë korumi, pika 8 dhe 9 e rendit të ditës, shtyhen për një mbledhje tjetër të komisionit.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:00.**

**Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

**Kryetari komisionit,**

-----  
**Lumir Abdixhiku**